

AKT THEMELIMI DHE STATUTI

SHOQËRIA "NEW WORLD" SHPK

TIRANË, SHQIPËRI

AKT THEMELIMI DHE STATUTI
i
Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar

"New World" Sh.p.k

KAPITULLI I

Data e Themelimit, Emri, Forma, Selia, Kohezgjatja

Neni 1

Data e themelimit dhe emërtimi

- Sot, më datën 19/11/2024 deklaroj themelimin e shoqërisë "New World" sh.p.k (në vijim "Shoqëria"), e ndjekur në mënyrë të pandashme nga shkurtimi "Shpk", cili përfaqëson formën ligjore të saj, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.
- Themelues i shoqërisë, Z. Giancarlo Fiorani, i biri i Amedeo Fiorani lindur më 20.08.1963, në qytetin e Genga-s, Itali dhe banues në Bangkok, adresa: Regent Home 13, 424 Soi Sukhumvit 93, Apt 710(424-135), BankgChak-Bangkok,10260 Tajlandë identifikuar me nr. pasaporte **YA8959765**, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
- Emri i shoqërisë është "**New World**" sh.p.k. (në vijim "Shoqëria"), e ndjekur në mënyrë të pandashme nga shkurtimi "Shpk", cili përfaqëson formën ligjore të saj, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.
- Në të gjitha dokumentat, faturat, njoftimet dhe botimet të lëshuara nga Shoqëria, pavarësisht nga mënyra e dërgimit, emri i saj do të ndiqet ose do të shoqërohet nga:
 - Fjalët "Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar" ose "shpk"
 - Numri Unik Identifikimit Subjektit (NUIS) të saj
 - Adresa e selisë
 - Informacion nëse shoqëria do jetë në proces likujdimi ose falimentimi
 - Emri tregtar (nëse do ketë)
 - Adresa zyrtare e email-it të shoqërisë

Neni 2


Forma Ligjore

- Shoqëria është një entitet ligjor shqiptar, dhe ka formën ligjore të një shoqërie me përgjegjesi të kufizuar ("shoqëri me përgjegjësi të kufizuar"), në pajtim me ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtaret dhe Shoqërите Tregtare" i ndryshuar, që këtu e në vijim do quhet ("Ligji i shoqërive").

Neni 3

Selia, Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit

- Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga Abdyl Frashëri, EGT Tower, Pallati 11/1, Kat 5, Tiranë. Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë selinë e saj, në çdo kohë në një adresë ose qytet tjetër të Shqipërisë.
- Shoqëria mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi kudo brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.



1

Neni 4
Kohëzgjatja

1. Kohëzgjatja e shoqërisë është për një periudhë të pacaktuar.

KAPITULLI II
Objekti

Neni 5
Objekti i Shoqërisë


1. Objekt i aktivitetit të shoqërisë është:

- Aktivitet konsulence dhe analizë të investimeve në fushën financiare, energjitike dhe industriale, aktivitet në fushën e kërkimit dhe gjetjes së investorëve për veprimtari në pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme;
- Operacione kërkimore/studimore në fushën e turizmit, infrastruktures, energjisë, shfrytëzimit minerar, agrikulturë etj.

Të drejtë e investimeve në fusha të ndryshme, në fushën e blerjes dhe shitjeve të pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme, mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave për të tretë, krijimin dhe drejtimin e të dhënave të cfarëdolloj tipi, aktiviteti për ndërhyrje kreditore në të gjitha format e parashikuara nga normativat përkatëse, ndërmjetësim në blerjen dhe në trajnimin e praktikave të financimit, leasing, hua, garancive, imobilare, praktika për kredi konsumi, pë shlyerje kredish;

- Asistencë për këshillime ekonomike dhe financiare, për studime të realizueshme, plane sipermarrjeje dhe analizë tregtare, formulimin, përshtatjen dhe ekzaminimin për llogari të të tretëve, të programeve financiare, të investimit apo zhvillim të përbashket, gjithashtu aktivitete kujdestarie për zhvillimin e projekteve ndërmarrëse dhe çfarëdolloj forme initiative të zhvillimit;
- Aktiviteti në fushën e investimeve në sektorin e pasurive të paluajtshme dhe të investimit të produkteve financiare ndërkombëtare, si dhe pjesëmarrje në minorancë ose mazhorancë në shoqëri shqiptare e të huaja. Shoqëria mund të japë shërbime të konsulencës drejtëpërdrejtë ose nëpërmjet pjesëmarrjes si dhe të kryejë aktivitete të raportimit dhe të paraqitjes;
- Aktivitete të blerjes dhe shitjes së aksioneve brenda dhe jashtë vendit, operacione tregtare dhe financiare me banka, me persona juridike, fizikë, shoqëria mund të japë garanci reale në favor të tretëve, të enteve publike, bankave apo dhe në favor të vetë ortakëve, operacione të këmbimeve valutore, marrjen e huave nga institucionet financiare apo individë të ndryshëm;
- Organizim të sipërmarrjeve edhe për paraqitje kërkese për financim të çfarëdolloj forme initiative të zhvillimit, organizim i sipërmarrjeve edhe për paraqitje kërkese për financim të çfarëdolloj tipi sipas asaj që është vendosur nga autoritetet vendore, kombëtare dhe komunitare;

Aktivitet në fushën e organizimit të eventeve, takimeve të biznesit dhe udhëtimeve, aktivitete në fushën e marketingut dhe publicitetit, dhënie me qira dhe shitje mjetesh/dhe pajisjesh të tjera, dhe rezervime/prenotime ambjentesh;



2

Shoqëria mund të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme, nën gjykimin e vetëm të Organit Administrativ për zbatimin dhe arritjen e objektit të veprimitarisë dhe vetëm për këtë qëllim, dhe më tej në formeën e veprimeve aksesore dhe jo themelore, mund të (deri në masën e lejuar me ligj): kryejë operacionet tregtare dhe industriale, financiare, bankare, hipotekuese, ekonomike dhe në lidhje me pasuri të paluajtshme; të kerkoje dhe marë çdo formë financimi nga Institutet kredidhënëse, bankat, shoqëritë dhe individët.

Shoqëria gjithashtu mund të përbushë të gjitha operacionet tregtare edhe të import - eksportit, industrialepër pasuri të paluajtshme dhe letra me vlerë që gjyket të jenë të nevojshme ose të dobishme për përbushjen e objektit të veprimitarisë si dhe mund të mbajë aksione në shoqëri të tjera, të japë kredi, lëshojë garanci dhe garanci të tjera në natyrë, edhe reale, të fitojë dhe cedojoë kredi.

Neni 6

Ndryshime

1. Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë objektin e veprimitarise se saj në çdo kohë siç parashikohet në këtë Statut me kusht që veprimtaria e saj të mos jetë në kundërshim me legjislacionin në fuqi në RSH.

KAPITULLI III

Kapitali regjistruar; Ortakët; Kuotat

Neni 7

Kapitali regjistruar

1. Kapitali regjistruar i Shoqërisë është 1000,00 (një mijë) Euro dhe përbëhet nga 1 (një) kuotë, me vlerë nominale 1000,00 (një mijë) Euro, të nënshkruara dhe të paguara plotësisht.

Neni 8

Ortaku i vetëm dhe Kuotat e tij

1. Kapitali regjistruar i shoqërisë "New World" sh.p. k është i zotëruar 100% nga Ortaku i Vetëm Z. **Giancarlo Fiorani**.
2. Ortaku i Vetëm, Z. **Giancarlo Fiorani** është zotëruar i kuotës me vlerë nominale 1000.00 (një mijë) Euro.
3. Ortaku i Vetëm i Shoqërisë ("Ortaku i Vetëm") gëzon përgjegjesi të kufizuar deri në limitin e kontributit përkatës në kapitalin e shoqërisë të përfaqësuar në kuota.

Neni 9

Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit Regjistruar

1. Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet ose zvogëlohet me vendim të Ortakut të Vetëm, në përputhje me Kapitullin IV të këtij Statuti, dhe kërkesave të detyrueshme të Ligjit të shoqërive tregtare.
2. Zmadhimi i kapitalit mund të realizohet me anë të kontributeve në para, me anë të kontributeve në natyrë, si dhe me përfshirjen e rezervave (nëse ka) ose fitimeve të akumuluara apo kthimit të borxhit në kapital.



A handwritten signature in blue ink, appearing to be a stylized 'J' or 'G' followed by other characters.

3. Zmadhimi i kapitalit mund të bëhet duke emetuar kuota të reja apo duke rritur vlerën nominale të kuotave ekzistuese. Pjesët e reja të kapitalit regjistruar do të nënshkruhen dhe vlera e tyre nominale do te paguhet plotësisht.
4. Zvogëlimi i kapitalit mund të bëhet vetëm duke zvogëluar vlerën nominale të kuotave ekzistuese.
5. Masa e zvogëlimit të kapitalit duhet të jetë e tillë që vlera e kapitalit të ri pas zvogëlimit të mos bjerë nën kufinjtë e kërkesave të kapitalit minimal konform Ligjit të Shoqërive.

Neni 10

Të drejtat dhe detyrimet e Ortakut të Vetëm

1. Ortaku i Vetëm zotëron 100% të kuotave të Shoqërisë. Në bazë të dispozitave të Ligjit të Shoqërive të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së ortakëve në shoqërinë me një ortak, do të ushtrohen nga Ortaku i vetëm. Të gjitha vendimet e tij do të regjistrohen në regjistrin e vendimeve. Një vendim i paregjistruar në këtë regjistër do të quhet i pavlefshëm.
2. Të drejtat dhe detyrimet që rezultojnë nga zotërimi i kuotave, transferohen tek çdo zotëruesh i ri për këto kuota.
3. Detyrimet e Shoqërisë janë të garantuara nga kapitali i saj dhe Ortaku mundet vetëm të mbajnë përgjegjësi brenda limitit të vlerës së kuotave që ata zotërojnë;
4. Shoqëria nuk mban përgjegjësi për borxhe ose detyrime të tjera të Ortaku të saj.

Neni 11

Fitimi dhe transferimi i kuotave

1. Kuotat e kapitalit dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
 - a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - b) shitblerjes;
 - c) trashëgimisë;
 - d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj
2. Kuotat e shoqërisë mund t'u transferohen ortakëve ekzistues të shoqërisë dhe personave të tretë brenda apo jashtë shoqërise, për aq kohe sa këta të fundit nuk ndalohen apo kufizohen në këtë të drejtë, nga ndonjë ligj tjetër në fuqi në Republikën e Shqipërisë, në momentin e realizimit të transferimit.
3. Transferimi i kuotave do bëhet në formë shkresore nëpërmjet kontratës përkatëse me akt notarial.

KREU IV

Asambleja e Përgjithshme - Ortaku i Vetëm

Neni 12

Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakut të Vetëm është organi drejtues i shoqërisë i cili merr vendimet mbi aktivitetin dhe politikat e saj ekonomike dhe tregtare.



A handwritten signature in blue ink, appearing to be a name, is placed here.

2. Në bazë të dispozitave të Ligjit të Shoqërive të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së ortakeve në shoqërinë me një ortak, do të ushtrohen nga Ortaku i Vetëm. Në vijim të këtij statuti, termi "Asambleja e Përgjithshme" ose "Asambleja" i referohet dhe nënkupton "Asamblenë e Ortakut të Vetëm", ose shkurt "Ortaku i Vetëm".
3. Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
 - a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe i audituesve ligjore;
 - d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
 - dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
 - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - i) çështje të tjera të parashikuara
4. Vendimet e Asamblesë të marra në përputhje me këtë Statut si dhe me Ligjin për Shoqëritë do të janë të detyrueshme për Shoqërinë.

Neni 13


Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme

1. Asambleja e Përgjithshme mund të thirret në çdo kohë nga:
 - a) Administratorët;
 - b) Ortakët e shoqërisë;

Neni 14

Mënyra e thirrjes së Asamblesë

1. Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vandin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpëra datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
2. Asambleja e Përgjithshme thirret të vendosë për çështjet e paraqitura në nenet e mësipërme.
3. Asambleja e Përgjithshme mund të mblidhet në selinë e Shoqërisë apo në çdo adresë tjetër të ndonjë qyteti brenda Republikës së Shqipërisë ose jashtë saj,



A handwritten signature in blue ink, consisting of several loops and strokes, is placed here.

- Administratoret duhet te mbajne procesverbalet e çdo mbledhjeje të Asamblesë së Përgjithshme, në përputhje me kërkesat e Ligjit të Shoqërive.

Neni 15

Përfaqësimi në Asamblenë e Përgjithshme

- Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
- Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në Asamblenë e Përgjithshme.
- Autorizimi jepet në formë shkresore vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme dhe është i vlefshëm edhe për mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

KREU V Administratorët

Neni 16


Caktimi Administratorëve

- Në përbushje të parashikimeve të nenit 12, pika 3 (c), emërimi dhe shkarkimi i administratorëve do të bëhet nga Asambleja e Përgjithshme.
- Shoqëria mund të drejtohet nga një ose disa Administratorë njëkohësisht.
- Administratorët mund të emërohen për një periudhë ushtrimi funksioni (mandat) jo më të madhe se 5 vite nga data e vendimit të emëritimit ose data e paracaktuar në vendimin e emëritimit, datë nga ku kjo detyrë merr fuqi ligjore.
- Mandati i administratorit mund të ripërtërihet dhe nuk parashikohen kufizime në numrin e ripërtëritjeve.
- Administratorët e Shoqërisë në momentin e themelimit të shoqërisë janë:
 - Z. Giancarlo Fiorani**, shtetas italian lindur më 20/08/1963 në qytetin e Genga me numër Pasaporte: **YA8959765**, banues në Bangkok, adresa: Regent Home 13, 424 Soi Sukhumvit 93, Apt 710 (424-135), BangChak-Bangkok 10260, Tajlandë.
- Afatet e emëritimit për administratorin e shoqërisë në momentin e themelimit, Z **Giancarlo Fiorani** janë respektivisht 5 vite, duke filluar që nga momenti kur kjo detyrë merr fuqi ligjore (dmth regjistrimi i shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit).

Neni 17

Kompetencat dhe detyrimet e Administratorëve

- Kompetencat e Administratorit në kuadër të përfaqësimit të Shoqërisë përfshijnë:
 - kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
 - kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;



- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj.
2. Administratorët kanë detyrimin të thërrasin asamblenë e përgjithshme në rastet kur:
- nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
 - shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
 - shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
 - ortakët e pakicës, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë, e kanë kërkuar mbledhjen e asamblesë duke i drejtuar një kërkesë me shkrim ose me postë elektronike administratorit
3. Administratori mund të heqë dorë në çdo kohë nga detyra e tij, nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar asamblesë së përgjithshme.

**Neni 18
Përfaqësimi**

- Për aq kohë sa nuk është parashikuar dhe nuk do parashikohet specifikisht me një nen të veçantë në statut, kompetencat dhe përgjegjsitë për secilin administrator janë të njëjta, dhe të pakufizuara brenda parashikimeve të këtij statuti dhe Ligjit të Shoqërisë.
- Sidoqoftë, administratorët që përfaqësojnë bashkërisht shoqérinë tregtare, mund të autorizojnë njërin apo disa prej tyre për kryerjen e disa veprimeve të caktuara apo për kryerjen e disa kategorive të caktuara veprimesh. Njoftimet e drejtuara secilit prej administratorëve janë të vlefshme e detyruese për shoqérinë.
- Tagrat e përfaqësimit të administratorëve dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

**KREU VI
Aktiviteti dhe administrimi financiar i Shoqërisë**

**Neni 19
Viti ekonomiko-financiar**

- Viti ekonomiko-financiar fillon në ditën e parë të muajit Janar dhe përfundon në ditën e fundit të muajit Dhjetor të secilit vit.



A handwritten signature in blue ink, appearing to be a stylized 'A' or 'N'.

2. Viti i parë finansiar nis në datën e themelimit të Shoqërisë. Viti i fundit finansiar përfundon në datën e prishjes ose përfundimit të afatit të ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë.

Neni 20

Mbajtja e Llogarive

1. Bilanci vjetor i Shoqërisë shqyrtohet në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme dhe i paraqitet organeve tatumore sipas ligjislacionit në fuqi të vitit pasardhës.
2. Kontabiliteti mbahet në gjuhën dhe në monedhen Shqiptare. Shoqeria mund të këtë edhe llogari të veçanta në valutë.

Neni 21

Rezultati finansiar dhe shpërndarja e fitimeve

1. Rezultati i Shoqërisë përcaktohet në bazë të pasqyrave financiare të aprovuar nga Asambleja e Përgjithshme.
2. Shoqeria mund të krijoje fonde rezerve për realizimin e objektit të saj.
3. Të ardhurat që do të rezultojnë në fund të mbylljes së çdo viti ushtrimor pas pagimit të tatimeve, mund të tërhiqen nga ortaku i shoqërisë ose mund të kalojnë në fitimet e akumuluara.

Neni 22

Auditimi i Pasqyrave Financiare

1. Nëse legjislacioni përkatës parashikon detyrimin e shoqërisë për auditimin ligjor të pasqyrave financiare, atëherë Asambleja e Përgjithshme në përbushje të kompetencave të parashikuara në nenin 12, pika 3 (ç) të statutit, duhet të caktojë një Auditues Ligjor ose Shoqëri Auditimi, për këtë qëllim.
2. Emërimi i Audituesit Ligjor duhet bërë çdo vit dhe për pasqyrat financiare të çdo viti në qoftë se ato dojenë objekt i auditimit ligjor sipas kërkesave të legjislacionit përkatës dhe emërimi duhet bërë publik në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
3. Edhe kur shoqëria nuk ka detyrim ligjor për auditimin e pasqyrave financiare, Asambleja e Përgjithshme, në mënyrë vullnetare mund të vendosi për auditimin e pasqyrave financiare dhe caktimin e një Audituesi Ligjor ose Shoqërie Auditimi për këtë qëllim.


KREU VII

Ndryshimi i Formes Ligjore dhe Prishja e shoqërisë

Neni 23

Ndryshimi i Formës Ligjore

1. Forma ligjore e Shoqërisë mund të ndryshojë me vendim të Asamblese së Përgjithshme sipas kompetencave të parashikuara në nenin 12, pika 3 (gj) këtu dhe në përputhje me dispozitat respektive në Legjislacionin e RSH.
2. Shoqëria e re do të përbushë të gjitha procedurat dhe kërkesat ligjore që parashikohen në dispozitat respektive të Legjislacionit në RSH.



8

Neni 24
Prishja e Shoqërisë

1. Shoqeria mund te prishet ne rrethanat e me poshtme:
 - a) si pasoje e perfundimit te kohezgjatjes për të cilin ishte themeluar;
 - b) me vendim te Asamblese se Pergjithshme;
 - c) hapje e një procedure falimentimi/likuidimi;
 - d) me vendim gjykate;
 - e) për arsyet tjetra të parashikuara nga Ortaketet në çdo kohë.
2. Administratori(et) regjistrojnë prishjen e Shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në përputhje me nenin 43 te Ligjit nr.9723, date 3.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit". Në rast se prishja e Shoqërise bëhet me vendim gjykate, gjykata, në perputhje me nenin 45 te Ligjit nr.9723, date 3.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit", ia dergon vendimin kësaj të fundit për regjistrim.

Neni 25
Mosmarrëveshjet

1. Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij Statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqerisë dhe të tretëve, në rast se palët nuk do arrijnë dakordësinë me vullnetin dhe konsensusin e tyre, atëhënë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve palët do t'i drejtohen Gjykatave kompetente përkatëse të Republikës së Shqipërisë.

Neni 26
Dispozita përfundimtare

1. Cdo çështje tjeter, e cila nuk është përmendur në këtë Statut, do të rregullohet nga dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare.
2. Ky Statut u redaktua në 2 kopje me përbajtje dhe vlera të njëjtë juridike, në gjuhen shqipe dhe u miratua në parim nen për nen nga Ortaku Themelues i shoqërisë "New World" sh.p.k.
3. Ky Statut nënshkruhet nga Ortaku i Vetëm në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tij origjinale.

PËR SHOQËRINË "NEW WORLD" SHPK

Giancarlo Fiorani

19/11/2024